



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-23-0763

Në ankesën e

Paditësit / Ankuesit

1.M P1

2.P P

3.M P2,

Të përfaqësuar nga Av. A B, Prishtinë.

Kundër

Të paditurat

1.NSH KBI "Kosova Export", përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit,** lagja Lakërishte- rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Prishtinë.

2.Komuna e Prishtinës.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Ganimete Puka gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësve të paraqitur kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, SCC-08-0223 të datës 29 nëntor 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 20 qershor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësve refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, SCC-08-0223 i datës 29 nëntor 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedurë ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 14 korrik 2008, paraardhësi i ndjerë paditësve N P dorëzoi në DHPGJS, një padi kundër të paditurës NSH KBI "Kosova Export" në Fushë Kosovë, me të cilën ai kërkoi që të urdhërohet e paditura që t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar paditësit në shumë që do ta caktojë eksperti me kamatë vonesë, duke filluar nga paraqitja e padisë e deri në pagesën përfundimtare, ose ti japë paditësit në pronësi dhe posedim tokën tjetër me bonitet të përshtatshëm. Paditësi pohoi se me Ujdi gjyqësore të Gjykatës Komunale në Prishtinë P.nr. 649/71, e fitoi të drejtën e pronësisë mbi paluajtshmërinë ngastër nr., e cila gjendet në vendin e quajtur "S" me kulturë arë e klasit 4 në sipërfaqe prej 4.22.95 ha ZK M, e cila është objekt i këtij kontesti. Poashtu, paditësi pohoi se në ndërkohë mësoi se kishte një ndryshim në regjistrin kadastral dhe se pasuria e paluajtshme e kontestuar evidentohet në emër të paditurave dhe personave të tretë. Në mbështetje të padisë ka bashkangjitur dokumentet në kopje si Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë P.br.649/71 të datës 26 prill 1972, vërtetimin nr. 952-01-4/920 të datës 10 korrik 1996 lidhur me parcelën kontestuese, lista poseduese e datës .. maj, Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë P.br. 1321/06 të datës 02 janar 2008 për shpalljen inkompetent në lidhje me padinë e njëjtë të dorëzuar në vitin 2006 në Gjykatën Komunale në Prishtinë, dhe njoftimin e datës 02 qershor 2008 drejtuar AKM për qëllimin e ngritjes së padisë në DHPGJS.

Me 23 korrik 2008 Trupi gjyqësor i DHPGJS-së lëshoi një urdhër me të cilin kërkoi nga paditësi që të precizojë dhe plotësojë padinë, ashtu që të deklarohet se në emër të kujt evidentohet prona kontestuese, dhe të prezantojë Fletën poseduese për gjendjen e tanishme të pronës kontestuese.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit me datë 04 gusht 2008 dorëzoi përgjigjen përmes parashtrësës në të cilën dha arsyet me shkrim rreth urdhrit, ku ka pohuar se fillimisht kishin paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, e cila në mbajtje të seancës kishte vendosur që të nxjerrët ekspertiza gjeodezike, kurse më vonë është shpallur in kompetente lëndore, dhe lënda është dashur t'i dërgohet DHPGJS-së. Ai pohon se Paditësi nuk e din bazën përmes të cilës i

është marr toka edhe pse ka jetuar në Kosovë deri në fund të luftës, kur dhe ka ikur në Serbi. Ai pohon se dokumentacioni i ka mbetur në shtëpinë në të cilën ka jetuar në Kosovë. Tutje ka shtuar se padisë i ka bashkangjitur certifikatën e Entit Gjeodezik Republikan të atëhershëm, dhe konsideron se paditësi është pronar në bazë të Ujdisë gjyqësore, dhe të gjitha dokumentet gjendet në arkivat e gjykatës dhe arkivat shtetërore.

Me datë 01 tetor 2008 Trupi gjykues i DHPGJS-së e përsëriti urdhrin, me të cilin kërkoi nga paditësi që të prezantoj prova shitesë dhe të prezantoj historiatin e pronës prej vitit 1971 e gjerë më sot, të deklarohej se në emër të kujt evidentohet prona kontestuese, të deklarohej se a ka parashtruar padi ndaj pronarit të pronës kontestuese, dhe të deklarohej se kur e ka humbur të drejtën e posedimit.

Me datë 22 tetor 2008, paditësi duke u përgjigjur në urdhrin e gjykatës pohoi se duhet të kërkohet nga sekretaria e Gjykatës Komunale që të ofrojë rastin kontestues, ose që të caktohet një ekspertizë e re, me qëllim të sqarimit të pyetjeve që i shtron gjykata. Po ashtu paditësi pohoi se së bashku me padinë dhe parashtrësën që i është përgjigjur urdhrin ka ofruar disa nga provat të cilat ka arrite ti ruaj. Më tej paditësi pohoi se si ka ndodhur humbja e të drejtave pronësore duhet të përgjigjet eksperti gjyqësorë.

Me datë 24 dhjetor 2009, paditësi me parashtrësë i propozoi DHPGJS-së që lënda të kthehet në Gjykatën Komunale në Prishtinë për vazhdimin e procedurës.

Me datë 11 shkurt 2010, AKP-ja parashtrroi mbrojtje në padi. Në mbroje në padi AKP-ja pohoi se kërkesëpadija nuk ka bazë ligjore, dhe si e tillë duhet të refuzohet si e pa bazuar. Tutje AKP-ja pohoi se, paditësi nuk ka prezantuar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimet e tij se e ka humbur të drejtën e pronës në ngastrën kontestuese, nga matjet kadastrale që janë bërë në vitin 1980. Tutje e paditura në mbrojtje në padi pohoi se edhe po të prezantonte paditësi ndonjë vendim të asaj natyre, nuk ka mundësi ligjore që tani pas disa dekadash të kërkoj kthimin e të drejtës së pronësisë apo kompensimin e dëmit. Më tej AKP-ja pohoi se paditësi nuk ka ofruar kurrfarë dëshmie se në vitet 1980, ka paraqitur

ndonjë ankesë apo mjete të tjera ligjore për mbrojtjen e të drejtës së tij pronësore. AKP-ja pohoi se mbi çfarë baze ligjore duhet të përgjigjet NSH KBI "Kosova Export" në Fush Kosovë, për çështjet juridiko-pronësore në mes të paditësit dhe personave të tretë. Në mbrojtjen në padi, AKP-ja ka theksuar se paditësi ka potencuar në padinë e tij se me matjet e vitit 1980, ngastra kontestuese kadastrale ka kaluar nga paditësi në të paditurën KBI "Kosova Export", dhe në emër të personave të tjerë, atëherë shtrohet pyetja se nëse edhe theksimet e tilla janë të vërteta, mbi çfarë bazë juridike mund të kërkojë paditësi kompensimin e plotë mbi pjesët kadastrale të cilët kanë kaluar nga paditësi në emër të personave të tretë. Në mbrojtjen në padi AKP-ja konstaton e padia nuk është e mbështetur me dëshmi relevante dhe fakte materiale, andaj si e tillë ajo duhet të refuzohet si e pa bazuar.

Me datë 02 qershor 2017, i autorizuari i paditësit dorëzoi në DHPGJS dokumentet vijuese në kopje si: autorizimin për përfaqësim, certifikatën e lëshuar nga Shërbimi për regjistrimin pronës së paluajtshme Prishtinë e dt. ..korrik., nr..., certifikatën e lëshuar nga Agjencia për Kadastër e Patundshmërive në Prishtinë datë .. dhjetor..., K, Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë P.br. 649/71 dhe Librat kadastrale të Zonës Kadastrale M.

Me datë 07 tetor 2017, paditësi parashtroi përgjigje në mbrojtjen e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësit pohuan se pretendimet e palës së paditur në mbrojtje në padi janë të pa bazuara. Paditësit ndër të tjera pohuan se ata kërkojnë kthimin në pronësi dhe posedim të këtyre ngastrave kadastrale, mbi bazën e së drejtës së pronësisë të themeluar mbi Ujdinë gjyqësore C.nr. 469/71 të datës 21 shtator 1971. Po ashtu paditësi pohoi se përkundër faktit se të drejtat pronësore kanë karakter absolut dhe nuk parashkruhen, ai ka ndërmarrë veprime aktive në drejtim të kërkimit për kthim të ngastrave pronësore të përmendura.

Me datë 12 dhjetor 2017, paditësi parashtroi propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit.

Me 21 dhjetor 2017, e paditura AKP parashtroi përgjigje në kërkesën e paditësit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit.

Me datë 26 shkurt 2018, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së me Aktvendimin SCC-08-0223 e refuzoi si të pa bazuar propozimin e paditësit për caktimin e masës së sigurisë.

Me datë 06 prill 2018, AKP-ja parashtroi kundërpërgjigje ndaj parashtresës së paditësve të datës 07 tetor 2017, në të cilën pohoi se mbetet në tërësi pranë mbrojtjes në padi, dhe fakteve tjera të theksuara me rastin e kundërshtimit të padisë së paditësit.

Me datë 22 shtator 2020, Kolegji i shkallës së I-rë i DHPGJS-së lëshoi urdhër me të cilin kërkoi nga Zyra Komunale Kadastrale në Prishtinë, shënimet historike kadastrale dhe shënimet e azhuruara kadastrale për të drejtat e pronës së patundshme në lidhje me ngastrën kadastrale që është objekt i këtij kontesti.

Me datë 01 tetor 2020, Drejtoria e Kadastrit në Komunën e Prishtinës e ka njoftuar gjykatën se në regjistrat e tyre kadastral as në gjendjen e mëhershme e as në gjendjen aktuale parcela kadastrale me numrin ZK M, nuk ekziston, andaj, në mënyrë që të janë sa me të saktë në dhënien e informatave kërkuan nga gjykata që të sigurojë saktë numrin e parcelës kadastrale.

Me datë 08 tetor 2020, Kolegji i shkallës së I-rë i DHPGJS-së, lëshoi një urdhër me të cilin kërkoi nga AKP-ja që të informojë gjykatën për numrin e parcelës kontestuese.

Me datë 15 tetor 2020, AKP-ja duke u përgjigjur në urdhrin e gjykatës, pohoi se lidhur me ngastrën nr. ZK M, shumë pak ekspert, apo fare nuk ka në Kosovë, që mund ta shndërrojë-identifikojë me numra të ngastrave adekuate. Kjo ngase duhet bazuar në shënimet kadastrale që janë transferuar në K të Serbisë.

Me datë 25 janar 2021, Kolegji i shkallës së I-rë i DHPGJS-së, e lëshoi një urdhër për paditësin me të cilin kërkoi nga paditësi që të bëjë precizimin e padisë në aspektin faktik dhe të sqarojë se cilat janë parcelat që janë objekt i këtij kontesti, pasi që parcelat që janë përmendur në padi, nuk ekzistojnë si numër në Regjistrat Kadastral pranë Komunës së Prishtinës.

Me datë 24 dhjetor 2021 përfaqësuesi i paditësve me parashtresë e ka bërë precizimin e padisë në aspektin subjektiv dhe objektiv në atë mënyrë që si paditës ka paraqitur M P1, P P dhe M P1 të gjithë trashëgimtarë ligjor të paditësit të ndjerë N P ndërsa si palë të paditur paraqiten AKP-ja, NSH "Kosova Export" dhe Komuna e Prishtinës. Parashtresës i ka bashkangjitur certifikatat e lindjes dhe certifikatën e vdekjes për paditësin-të ndjerin N P, autorizimin për përfaqësim marrë nga paditësit-trashëgimtarët ligjor, Aktvendimin për shqyrtimin e trashëgimisë UPP679-2020 të dt.17.02.2021 i lëshuar nga Noteri I S në Beograd, dhe skicat për ngastrat kontestuese. Ndërsa, sa i përket precizimit të padisë në aspektin objektiv, si objekt të këtij kontesti i precizoi parcelat nga numri P-..... deri në numrin P-..... si dhe parcelën me nr. P-..... Tutje ka precizuar se cilat prej tyre mund tu kthehen pronarëve nga Komuna e Prishtinës, dhe cilat në pamundësi të kompensimit me prona tjera pasi që tani kanë pronar të ri, t'ua kompensoj në të holla, në vlerë proporcionale të tregut.

Me datë 09 nëntor 2022, e paditura Komuna e Prishtinës, ka paraqitur historiatin për parcelat kadastrale nr.... dhe ... ZK M, ku ka deklaruar se këto parcela me sipërfaqe prej 11180 m2 para vitit 1999, sipas sistemit elektronik e në programin e quajtur B, kanë qenë në emër të Komunës së Prishtinës. Në këtë parashtresë ka bërë elaborimin se si kanë kaluar procedurat e pronësisë për këto parcela kadastrale. Parashtresës i ka bashkangjitur këto prova: Gjendja e vjetër e parc.nr..., Aktvendimin e Komunës së Prishtinës të datës 03 08.2005, Aktvendimin nr.011-952-1-415 dt.25.03.2013, Ekspertizën e gjeodezisë për lëndën C.nr.291/02, Aktgjykimin C.nr.291/2002 dt.09.03.2010, Vendim për miratimin e planit rregullativ për lagjen "M" në Prishtinë 01.nr.35-18186 dt.03.08.2005, Vendimin për lejimin e dhënies së tokës pronarëve privat si kompensim për tokën e tyre afër deponisë së mbeturinave 01.nr.46-409 dt.26.03.2002, Gjendja e vjetër e parc.kad.nr....., Aktvendim nr.05-952-1-2766 dt.31.12.2009, disa kontrata për shitblerjen e paluajtshmërisë dt.15.05.2006, Kontrata për bashkimin e pronave të paluajtshme dhe krijimin e bashkëpronësisë LRP.mr.... Ref.... me shkresat tjera, Regjistrimi i fletëparaqitjeve - bashkimi i parcelave ... dhe.... me numrin e ri ... , Aktvendim nr.011-940/01-0263720/19 i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Aktvendim nr.011-463-2/3078/20 i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Pëlqimi paraprak për shpronësimin e parc.kad.nr.... ZK M, Aktvendim për zbatimin e

ndërrimeve në operatin kadastral, Gjendja e vjetër e parc.kad.nr.... , Aktvendimi C.nr.1269/10 dt.09.11.2010, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.1886/14 dt.06.06.2014, Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1269/10 dt.14.03.2014, Aktvendimin nr.011-016-267580 i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Kopje e planit parc.kad.nr....., Marrëveshje mes Komunës së Prishtinës dhe N.N.P Standard, Aktvendim nr.011-940/01-137591/17 dt.08.06.2017 i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Marrëveshje për bashkimin e pronave të paluajtshme LRP.nr.... Ref...., Kontratë për investime të përbashkëta nr... dt....., Kontratë për bashkimin e mjeteve për ndërtimin e përbashkët dt....., Certifikatat e pronësisë për parcelat kontestuese.

Me datë 19 janar 2023, i autorizuari i palës paditëse ka bërë riprecizimin e kërkesëpadisë në kuptimin objektiv, ashtu që lidhur me ngastrat kadastrale P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., dhe P-..... ka kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë dhe të obligohet AKP-ja dhe Komuna e Prishtinës, t'ua kthej pronat trashëgimtarëve të N P Ndërsa, për parcelat P-....., P-....., dhe P-....., në sipërfaqe prej 1828m², paditësit kërkojnë kompensimin e dëmit nga Komuna e Prishtinës, pasi që nuk dihet se si janë bartur pronat nga AKP-ja tek Komuna e Prishtinës, dhe tani ato prona kanë pronar të ri. Ashtu që Komuna e Prishtinës në pamundësi ti kthej kompensimet me prona tjera në vlerë proporcionale atëherë, ti kompensoj në të holla.

Me datë 26 shkurt 2023, e paditura AKP-ja ka paraqitur përgjigje në urdhër përmes të cilit ka pohuar se ngastrat kadastrale nr... dhe nr..... në bazë të provave që posedon deri në vitin 1986, janë evidentuar në emër të S P dhe në këtë vit janë eksproprijuar në interes të Komunës së Prishtinës. AKP-ja ka pohuar se lidhur me padinë e paditësve për të vërtetuar të drejtën e pronësisë pronësinë për ngastrat kadastrale e përshkruara, për tokën në të cilën thuhet se paditësit ishin shfrytëzues deri në vitin 1999, është padi në tërësi e bazuar, dhe byzohet në të dhënat e organeve paralele të Serbisë. AKP-ja ka pohuar se këto ngastra kanë qenë në pronësi private të S P deri në eksproprijimin nga Komuna e Prishtinës, kjo është vërtetuar edhe me Aktgjykimin C.nr.291/02 dt.09.03.2010, për të cilin pretendim ka bashkangjitur si prova këto aktgjykimet: C.nr.291/02, C.nr.3109/13, Ac.nr.4885/2016 dhe Rev.nr.31/2021.

Kolegji i shkallës së I-rë i ka caktuar dhe mbajtur disa seanca gjyqësore lidhur me padinë. Në seancën dëgjimore të fundit i autorizuari i palës paditëse ka deklaruar se mbetet në tërësi pran padisë dhe kërkesës së saj dhe se pas pranimit të certifikatave të pronësisë dhe historiatin e disa nga pronave të cilat kanë qenë të bashkëngjitura apo në kufijtë kadastral në ngastrat kadastrale të cilat janë objekt i kërkesëpadisë ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në kuptimin objektiv duke sqaruar se njëra nga pronat e cila është tjetërsuar tek palët e treta dhe janë ndërtuar objektet banesore është bashkuar me ngastra të tjera duke formuar një ngastër tjetër kadastrale, kurse sipërfaqja e cila i është bashkuar nga pjesa që do ti takonte tani paditësve është 1828m², të gjitha këto precizime janë bërë pasi që deri në këtë fazë Komuna e Prishtinës asnjëherë nuk na ka pajisur me dokumentacionin e pronësisë së këtyre ngastrave dhe kësaj nuk e kemi pasur plotësisht të qartë se si janë transformuar, formuar apo bashkuar këto parcela. Në aspektet të tjera kjo kërkesëpadi mbetet e njëjtë edhe sa i përket aspektit subjektiv AKP-së dhe Komunës së Prishtinës pasi që këto prona kanë qenë pronë e saj dhe raporti juridik i fitimit të pronësisë nga paraardhësi i paditësve ka qenë pikërisht me NSH "Agrokosova" e cila është nën menaxhimin e AKP-së, përkatësisht pronat për të cilat pretendohet pronësia mbi to. Tutje shtoi se të gjitha provat e bashkëngjitura padisë dëshmojnë në mënyrë të pa kontestueshme se tani i ndjeri N P në bazë të Ujdisë gjyqësore të dt.21.09.1971 ka fituar të drejtën e pronësisë mbi këtë paluajtshmëri e cila në atë kohe ka qenë e regjistruar me numrin e ngastrës... Ndryshimi i numrit të paluajtshmërisë vërtetohet edhe nga certifikata e Entit Republikan të gjeodezisë për Komunën e Prishtinës të dt.26.11.2016, përmes të cilës dokumentohet se në vitet 80-ta janë bërë matjet aerofotografike përmes të cilave nuk dihet se si kjo paluajtshmëri është transferuar tek një pronarë i ri dhe nuk dihet se si ka marrë numër të ri në regjistrat kadastral .. dhe Në i kemi kërkuar AKP-së që të na siguroj ujdinë origjinale të dt. 21.09.1971, por i njëjta ka deklaruar se nuk e sigurojmë një prove të tillë dhe nuk mund të na detyroj gjykata por ka deklaruar se nuk e kemi kontestuar asnjëherë të njëjtën edhe nuk e kontestojmë as tani. Pra, fakti se kjo pronë është regjistruar në emër të N P nuk kontestohet nga e paditura e dyte por, pretendohet se i njëjti e ka shitur fakt i cili nuk qëndron për arsye se në sistemin e ish Jugosllavisë të gjitha ndryshimet kadastrale mbi pronësisë është dashur që të evidentohen në regjistrat kadastral dhe një

pretendim i tille nuk përbën provë apo fakt të provuar e aq me tepër për arsye se ne i kemi dorëzuar gjykatës një mori provash që dëshmojnë se kjo ujdi gjyqësore gjendet e regjistruar në regjistrat e ish Gjykatës Komunale në Prishtinë e vërtetuar nga arkivi ndër komunal i Prishtinës i dt.12.01.2022, në origjinal i vërtetuar nga aktvendimi mbi korrigjimin e ujdisë së dt.21.01.1971 e dt. 26.04.1972 e cila po ashtu vërtetohet se është e regjistruar në librat e regjistrat kadastral lidhur me këtë paluajtshmëri dhe të njëjtat vërtetohen se kanë shërbyer si bazë për regjistrimin e saj në ekstraktin e fletës poseduese nr.230 të dt.10.05.1972 përmes të cilës shihet se kjo paluajtshme ri është regjistruar në emër të N P P Po ashtu kjo vërtetohet edhe nga regjistri i ngastrave kadastrale të zonës kadastrale M e nxjerrur me 09.05.2017, nga shërbimi për kadastër paluajtshmëri të Prishtinës ku vërtetohet se si bazë juridike e regjistrimit të pronësisë në emër të N P nga Agrokosova shërben Ujdia gjyqësore e dt.21.09.1971. Të gjitha këto pretendime konfirmohen edhe nga certifikata e nxjerrë me dt.10.07.1996 nga instituti për gjeodezi dhe kadastër i Komunës së Prishtinës, që vërtetohet se i njëjti ka qenë i regjistruar si pronarë i kësaj paluajtshmërisë mbi bazën e vendimit përkatësisht ujdisë gjyqësore me nr. P.nr.649/71 dhe se ka qenë e tillë deri në regjistrimet e reja aerofotografike ZK M, të cilat janë bërë në vitin 1980. Të gjitha këto prova përveç certifikatës apo historiatit të pronës të datës 26.12.2016 dhe regjistri i pronave në regjistrat kadastral dt.09.05.2017, janë prova të nxjerra nga organet të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës.

Në fjalën përfundimtare të paraqitur me shkrim i autorizuari i palës paditëse ka pohuar se nga provat të cilat i kemi dorëzuar në gjykatë, dëshmohet bazueshmëria e pretendimeve pronësore të paditësve. Nuk ka dyshim se në bazë të ujdisë gjyqësore të dt.21.09.1971 të lidhur në mes të NSH "Agro Kosova" dhe N P kjo paluajtshmëria ka kaluar në pronësi të paarardhësit juridik të paditësve, fakt ky i regjistruar nga arkivi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, ku figuron si lëndë e përfunduar kjo ujdi gjyqësore me nr. rendor 649. Se prona e regjistruar me nr..... ka kaluar në pronësi të N Pe vërteton edhe Aktvendimi për korrigjimin e ujdisë gjyqësore P.br.649/71 dt.26.04.1982, ku është bërë përmirësimi i fletës poseduese nga .. në .. Me këtë ujdi i njëjti e ka bërë regjistrimin e pronës në emër të tij në regjistrat kadastral, e vërtetuar nga fleta poseduese e dt..... Faktin se është lidhur kjo ujdi nuk e ka kundërshtuar

asnjëherë as përfaqësuesi i AKP-së, kurse faktin se ka kaluar kjo pronë në emër të AKP-së në vitet e 80-ta, e pastaj në emër të Komunës së Prishtinës, e kanë ndryshuar edhe nr. kadastral, është shpjeguar nga certifikatat, përkatësisht nga historiat i pronës i siguruar nga Enti Republikan i Gjeodezisë – Shërbimi për Kadastër të Patundshmërisë Prishtinë, i Republikës së Serbisë. Kjo e shpjegon historinë dhe bazën ligjore të kalimit dhe regjistrimit të pronësisë në emër të N P. Po ashtu, se kjo pronë ka qenë e regjistruar në emër të N P e ka vërtetuar edhe Komuna e Prishtinës kur ka deklaruar se nuk ka të dhëna se si kjo pronë ka kaluar në emër të Komunës së Prishtinës. Andaj i ka kërkuar gjykatës që të aprovoj në tërësi kërkesëpadinë si të bazuar.

Përfaqësuesi i AKP-së ka deklaruar se mbetet pranë mbrojtjes dhe të gjitha kundërshtimeve të paraqitura deri tani, duke konsideruar se asnjë nga provat në të cilat bazohet kërkesëpadia nuk është për tu falur besimi se është ashtu siç shkruan në kërkesëpadi në të cilën paditësi thekson se deri në fund të vitit 1999 ishte duke shfrytëzuar pronën. Tutje përfaqësuesi i të paditurës shtoi se e kundërshton këtë pretendim dhe gjykatës i kemi ofruar argumente se deri në vitin 1985 e njëjta pronë e regjistrua me nr... dhe, ka qenë në emër të personit fizik S P ndaj të cilit është udhëhequr procedurë e shpronësimit, që i bie se kjo procedurë është udhëhequr në kohën kur ka qenë historiat i pronave komplet në Kosovë përkatësisht në Prishtinë, dhe identifikimi i pronësisë se tij është bërë në mënyrë më precize deri sa në vitin 1987 i njëjti e ka pranuar kompensimin për këtë pronë. Atëherë përfaqësuesi shtroi pyetjen ku ishte N P në atë kohë kur lejoi që kjo pronë të shpronësohej nga dikush tjetër, e jo nga ai, derisa thirret se ka një Ujdi gjyqësor për këtë pronë, të cilën si palë e paditur nuk e konsideron si provë valide. Po ashtu, në fjalën përfundimtare sikurse edhe në përgjigje në precizim të padisë, theksoi se gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se AKP-ja për ngastrat kadastrale nr... dhe nr..... deri në vitin 1985 kanë qenë të evidentuara në emër të S P dhe në këtë vit janë ekspropriuar nga Komuna e Prishtinës. Andaj kërkoi nga gjykata që ta refuzoj kërkesëpadinë si të pa themeltë dhe të pa argumentuar ligjërisht.

E paditura e dytë- përfaqësuesja e Komunës së Prishtinës si gjatë shqyrtimit gjyqësor ashtu edhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar kërkesëpadinë duke shtuar se kësaj padie i mungon legjitimiteti real aktiv për shkak se nga

shkresat e lëndës shihet se ngastrat kadastrale janë eksproprijuar nga Komuna e Prishtinës nga S P dhe paditësi nuk paraqitet si pronar i tyre. Por, edhe nëse ka qenë pronar i tyre nuk ka mundësi që i njëjti të mos jetë interesuar dhe nuk ka paraqitur asnjë mjet juridik për të kthyer pronësinë. Sipas certifikatës së pronës B, sipas listës poseduese nr.562, vërtetohet fakti se eksproprijimi i parcelës kadastrale nr.... dhe ... ZK M sipas Aktvendimit 07.nr.465-25/85 dt.08.07.1985 vazhdimisht është evidentuar si pronë shoqërore. Si bazë juridike ka përmendur nenet 221 dhe 226 të Ligjit për Punën e Bashkuar, si dhe nenin 20 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronëso-ro-Juridike. Ka shtuar se sa i përket Ujdisë gjyqësore e njëjta asnjëherë nuk është ekzekutuar dhe nuk prodhon efekt juridik. Gjithashtu sipas provave që janë bashkëngjitur nga K i Serbisë, të njëjtit kërkoi nga gjykata te mos i merr për bazë, sepse të njëjtave nuk mund tu falet besimi pasi që nuk mund të vërtetohet se a janë të ligjshme dhe identike origjinale derisa, Republika e Serbisë nuk e njeh Republikën e Kosovës. Tutje ka paraqitur një historik të shkurtër të lëndës kontestuese të S PC.nr.291/02. Fjalës përfundimtare të dorëzuar me shkrim në gjykatë, i ka bashkëngjitur si prova: Padinë e dt.20.03.2002, Fletën poseduese nr... dt.12.02.2002, Fletën poseduese nr.. dt., Kopjen e planit, Skicën e terrenit të dimensionuar, Ekspertizën gjeodezike, Ofertën nr.376/84-19 dt.29.05.1985, Procesverbalin e vitit 29.05.1987, Ankesën e dt. 29.07.1985, Fletën poseduese nr.. dhe Vërtetimin e dt.02.06.1987.Krejt në fund i propozoi gjykatës që pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar.

Me datë 29 nëntor 2023, Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së me Aktgjykimin SCC-08-0223, padinë e paditëse e refuzon si të pa bazuar për të gjitha ngastrat e kërkuara, P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., dhe P-....., si dhe është refuzuar edhe kërkesa alternativa që ti bëhet kompenzimi në të holla për parcelat P-....., P-....., dhe P-....., në sip.prej 1828m2.

Kolegji I Shkallës së I-rë të DHPGJS-së ka arsyetuar se pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të lartcekura dhe thënieve të palëve ndërgjyqëse, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç, dhe të gjitha ato së bashku, ka

vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kolegji i shkallës së I-rë i DHPGJS-së ka arsyetuar se pas administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, gjeti se sipas të dhënave të fletës poseduese të datës 28.10.2008 së pari parcela kadastrale nr.... me sipërfaqe prej 25128m² ZK M, është ndarë dhe janë krijuar parcelat nr.... me sipërfaqe 21399m², dhe ...me sipërfaqe prej 3729m².

Pastaj sipas regjistrimit të fletëparaqitjes nr.79/2013 të dt.11.11.2013, parcela kadastrale nr... ZK M në sipërfaqe prej 21399m², është ndarë dhe janë krijuar parcelat kadastrale nr..., ..., ..., ..., ..., ..., ..., ..., ..., ..., ..ZK M.

Kurse, se sipas Regjistrimit të fletëparaqitjes nr.107/2003 të dt.15.12.2003, parcela kadastrale nr..... ZK M në sipërfaqe prej 11180m², është ndarë dhe janë krijuar parcelat kadastrale nr...,...,... dhe ZK M.

Kolegji i shkallës së I-rë konstatoi se sipas Aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër e Komunës së Prishtinës nr.011-952-1-415 të dt.25.03.2013, parcela kadastrale nr... ZK M në sipërfaqe prej 21399m², ka kaluar në emër të S P sipas Aktgjykimit të Gjykatës Komonale në Prishtinë C.nr.2911/2002 dt.09.03.2010.

Tutje Kolegji i shkallës së I-rë konstatoi se sipas Aktvendimit të Drejtorisë për Kadastër nr. dt.03.11.2008 parcela kadastrale nr....ZK M, ka kaluar në emër të E H dhe G H me $\frac{1}{2}$, duke u bazuar në Aktvendimin e lëshuar nga Drejtoria për pronë e Komunës së Prishtinës me nr.08-456-16401 të dt.02.06.2008, Marrëveshja mbi kompensimin, Vendimi 01.nr.35-18186 dt.03.08.2005, si dhe Dërgimi i marrëveshjes për kompensim me nr.,08.456-16401/08 dt.08.09.2008. Pastaj këto prona në emër të kontratës mbi dhuratën LRP...Nr.Ref.... e dt....., kanë kaluar në emër të: pjesa e parcelës prej $\frac{1}{2}$ nga G H, ka kaluar në emër të L H si dhe pjesa e $\frac{1}{2}$ nga ... në emër të F H.

Tutje Kolegji i shkallës së parë konstatoi, se sipas Aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.11-030/04-0211281/20 të dt.07.02.2022, parcelat kadastrale nr..., ..., ..., ..., ..., ..., ..., ..., ..., ..., dhe ... ZK M, kanë kaluar

Kolegji i shkallës së I-rë konstatoi se paluajtshmëria kontestuese nr... në sipërfaqe prej 2,51.28 ha, dhe pjesa e ngastrës nr. në sipërfaqe prej 0,47.52 ha, deri në vitin 1985 ka qenë në pronësi të S P, kur ishte eksproprijuar nga Komuna e Prishtinës, dhe se paditësi përtej çdo afati ligjor deri në kohën e paraqitjes së padisë në gjykatë në vitin 2006, asnjëherë me asnjë dokument nuk ia vërtetoi gjykatës se është interesuar që paluajtshmëria kontestuese të kalojë në pronësi të tij, aq më pak i njëjti asnjëherë nuk është futur në posedim të saj.

Kolegji i shkallës së I-rë konstatoi se pretendimet e paditësit se e ka humbur pronësinë me regjistrimet e vitit 1980, janë të pa bazuara dhe të pa vërtetuara. Andaj, e paditura në mbrojtje me të drejtë ka theksuar se paditësi nuk ka prezantuar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimet e tij se e ka humbur të drejtën e pronës në ngastrën kontestuese nga matjet kadastrale që janë bërë në vitin 1980.

Tutje Kolegji i shkallës së I-rë konstatoi se e drejta e pronësisë është e drejtë subjektive e karakterit absolut dhe si e tillë gëzon mbrojtje juridike në të gjitha sistemet juridike dhe se sendet e paluajtshme të cilat janë të regjistruara në librat kadastrale, vlen supozimi se sendi është në pronësi të personit në emër të të cilit është e regjistruar, mirëpo edhe nëse paluajtshmëria nuk është e regjistruar në emër të atij që kërkon pronësinë, duhet të argumenton se i takon ajo e drejtë. Kështu, gjykata erdhi në përfundim se paditësi nuk arriti të argumentoj se i takon e drejta e pretenduar.

Me datë 15 dhjetor 2023, paditësit përmes postës e kanë dërguar në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, SCC-08-0223 të datës 29 nëntor 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkojnë nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të aprovohet kërkesëpapia si e bazuar dhe të vërtetohet se paditësit e kanë të drejtën e pronësisë për ngastrat kadastrale P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., P-....., dhe P-....., si dhe alternativë është që ti bëhet kompenzimi në të holla, për parcelat P-....., P-....., dhe P-....., në sipërfaqe prej

1828m², ose të anulohet Aktgjykimi I Shkallës së I-rë dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Për më tepër në ankesë paditësit kanë pohuar se Aktgjykimi i Kolegjit të Shkallës së I-rë është nxjerrë me shkelje absolute të dispozitave të nenit 182 par. 2 pika n) të LPK-së, pasi që Aktgjykimi nuk ka fare arsyetim lidhur me pikat e dispozitivit, nuk janë treguar fare arsytet për faktet vendimtare ose ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyetim pohohet për bazën ligjore dhe zbatueshmërinë materiale të normave. Tutje në ankesë paditësit kanë pohuar se Kolegji i Shkallës së I-rë ka bërë zbatim të gabueshëm edhe të së drejtës materiale duke u mbështetur në pretendimet se S P së pari i ka blerë këto paluajtshmëri kontestuese nga M K e më pas kanë qenë pronësi të tyre, përkatësisht ngastrat nr..., në sipërfaqe prej 2,51.38 ha dhe, me sipërfaqe prej 0,47.52 ha, duke qenë në pronësi të tij deri në vitin 1985, kur pronat ishin ekspropriuar nga Komuna e Prishtinës. Paditësit pohojnë se së pari nuk e ekziston asnjë provë materiale që vërteton se M K i ka shitur këto ngastra kadastrale kontestuese S P. Së dyti nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme të Kosovës, përmes të cilave refuzohet në tërësi padia e paditësit S P për vërtetim pronësie ndaj Komunës së Prishtinës, i njëjti pretendon se ka qenë posedues i paluajtshmërive kontestuese e jo pronar ligjor (intabular). Së treti Gjykata e Shkallës së I-rë ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale edhe me rastin e konstatimit se janë të pa bazuar pretendimet e paditësit se i njëjti ka humbur të drejtën e pronësisë me regjistrimin e vitit 1980. Gjykata e Shkallës së I-rë ka marrë për bazë pretendimet e përfaqësuesit të AKP-së, kurse vet përfaqësuesi i AKP-së në seancën dëgjimore ka theksuar se nuk e mohojnë faktin se këto paluajtshmëri janë regjistruar në bazë të Ujdisë gjyqësore të datës 21.09.1971 dhe Aktvendimit për korigjim të ujdisë gjyqësore të datës 26.05.1972 në emër të N P por pretendojnë se N P më pas ja ka shitur S P. Kësisoj arsyetimi i Kolegjit të Shkallës së I-rë është kontradiktor dhe i paqëndrueshëm me vet thëniet e përfaqësuesit të AKP-së. Tutje në ankesë paditësit kanë pohuar se në bazë të historiatit të pronës i siguruar nga Enti republikan i gjeodezisë – shërbimi për kadastrë të patundshmërisë Prishtinë i Republikës së Serbisë i datës 26.12.2016, vërtetohet saktësisht fakti se si ka kaluar kjo pronë në emër të AKP-së në vitet e 80-ta e pastaj të Komunës së Prishtinës dhe si janë ndryshuar edhe numrat kadastral. Kjo çështje është shpjeguar qartë nga

certifikata me matjen shtetërore aerofotogrametrike që ka filluar nga puna në vitin 1972 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1980 për Komunën Kadastrale M. Kjo certifikatë e historiatit përshkruar edhe historinë dhe bazën ligjore të kalimit dhe regjistrimit të pronësisë në emër të N P e të cilat prova në tërësinë e tyre janë në lidhmëni dhe në përputhje me njëra tjetrën. Fakti se kjo pronë ka qenë e regjistruar në emër të N P dhe nuk dihet se si ka kaluar në emër të Komunës së Prishtinës vërtetohet edhe nga vet Komuna e Prishtinës, pasi që nga kërkesa për historiatin e pronës e njëjta ka theksuar se nuk ka asnjë të dhënë lidhur me bazën juridike të regjistrimit të kësaj prone në emër të saj. Paraardhësi i paditësve është i interesuar për pronën e tij në sipërfaqe prej 4,22.95 ha, e vërtetuar edhe nga certifikata e datës 10.07.1996 e kadastrit të Prishtinës, në të cilin theksohet se regjistrimi i pronësisë në emër të N P ka qenë i themeluar në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale P.nr.649/71 dhe kjo gjendje e regjistrimit të pronësisë ka qenë e evidentuar deri në matjet apo regjistrimet e reja aerofotogrametrike të cilat kanë hyrë në fuqi në vitin 1980, për ZK M. Tutje në ankesë paditësit pretendojnë se Kolegji i Shkallës së I-rë ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike edhe me faktin se nuk i ka vërtetuar fare faktet e parashtruara nga paditësit, të mbështetura me prova materiale, zyrtare të regjistruara në regjistrat zyrtar të ish Gjykatës Komunale në Prishtinë, Arkivit komunal të Komunës së Prishtinës dhe Arkivit të Republikës së Serbisë. Të gjitha këto prova janë pranuar si të vërteta dhe origjinale nga vet përfaqësuesi i AKP-së. Paditësit pohojnë se nuk ka dyshim se paluajtshmëritë lëndore kanë qenë të regjistruara në regjistrin kadastral në emër të paraardhësit të tyre, por që këtë të drejtë e kanë humbur pas matjeve të reja aerofotogrametrike. Tutje paditësit pohojnë se fakti që prona lëndore ishte e regjistruar në pronësi të ish N P ngastra e vërteton edhe Aktvendimi mbi korigjimin e ujdisë gjyqësore të datës 21 janar 1971 dhe i datës 26 prill 1972, lëshuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë me numrin e lëndës P.br.649/71. Tutje ata pohojnë se fakti se paluajtshmëria lëndore para regjistrimit të saj në emër të N P ka qenë e regjistruar në emër të NSH "Agrokosova" me numrin e fletës poseduese 188 e nxjerrë me datë 19.05.2017. Paditësit pohojnë se fakti që N P ka qenë pronar i paluajtshmërinë vërtetohet edhe me certifikatën e datës 10.07.1996 të Kadastrit të Prishtinës. Ndërsa fakt se S P nuk ka qenë asnjëherë pronar ligjor i këtyre patundshmërive kontestuese por vetëm pretendues si posedues dhe shfrytëzues i pa penguar, vërtetohet edhe nga vendimet e

Gjykatës Themelore në Prishtinë, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme. Andaj nga këto arsye ata kanë kërkuar që të aprovohet padia e tyre si e bazuar.

Me datë 19 janar 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një përgjigje ndaj ankesës së paditësve. Në këtë parashtresë AKP-ja i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të paditësve duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj dhe mbështet në tërësi aktgjykimin e ankimuar duke e konsideruar si të drejtë dhe të bazuar në ligj. AKP-ja tutje ka pohuar....

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësve refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paraardhësi i ndjerë i paditësve N P me datë 14 korrik 2008 e ka dorëzuar një padi pronësore në DHPGJS duke kërkuar nga Gjykata që të vërtetohet e drejta e tij e pronësisë për ngastrën kadastrale nr....., në vendin e quajtur "S", në sipërfaq prej 4,22.95 ha, ZK M.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se pasardhësit e paditësit të ndjerë, M P1, P P dhe M P1, me datë 24 dhjetor 2021 e kanë dorëzuar një parashtresë në DHPGJS me ç`rast kanë bërë precizimin e padisë në aspektin subjektiv dhe në atë objektiv. Në aspektin subjektiv si të paditur janë paraqitur AKP-ja dhe NSH "Kosova Export", si dhe e paditur Komuna e Prishtinës. Në aspektin objektiv padia është precizuar, duke i kërkuar ngastrat P-..... deri në numrin P-....., si dhe ngastrën me numër P-..... Me këtë parashtresë ata kanë kërkuar që për një numër të tyre është kërkuar e drejta e pronësisë, ndërsa për një numër që nuk mund të

kthehen pasi që janë në emër të personave të tretë, kanë kërkuar kompensim në të holla në vlerë proporcionale të tregut.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësit edhe me datë 19 janar 2023 e kanë dorëzuar një parashtesë një DHPGJS me çrast edhe një here e kanë ri precizuar kërkesëpadinë e tyre në kuptimin objektiv, duke i kërkuar ngastrat vijuese:

P-....., P-....., P-.....,

P-....., P-....., P-.....,

P-....., P-....., P-.....,

P-....., P-....., P-.....,

P-....., P-....., P-.....,

P-....., P-....., P-....., dhe

P-.....

Me këtë parashtesën e fundit paditësit për ngastrat: P-....., P-....., dhe P-....., në sipërfaqe prej 1828 m² ata kërkojnë kompensim dëmi, meqë këto prona tash kanë pronar të ri, dhe nuk mund të kthehen.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paraardhësi i ndjerë i paditësve N P dhe pasardhësit e tij, M P1, P P dhe M P2 padinë e tyre pronësore, e kanë bazuar në Ujdinë gjyqësore të arritur në Gjykatën Komunale të Prishtinës në lëndën P.br.649/71. Kjo ujdi ishte arritur në vitin 1971 me NSH "Agrokosova" lidhur me ngastrën nr..... në vendin e quajtur "S", në sipërfaqe prej 4,22.95 ha, ZK M.

Numri i ngastrës nr....., vërehet se është nga kadatri përshkrues që aso kohe ishte në fuqi, e nuk është ngastër me numër të kadastrit aktual në fuqi.

Në bazë të dosjes vërehet se paraardhësi i ndjerë i paditësve me padinë e tij dorëzuar me 14 korrik 2008, nuk e ka sjellë pajtimin gjyqësor të arritur në lëndën P.br.649/71, por e ka sjellë një Aktvendim të kësaj gjykate P.br.649/71 të datës 26.04.1972, me të cilën përimitohet ujdia e arritur gjyqësore, lidhur me numrin e fletës poseduese nr... në.., ZK M.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësi me padinë e tij, dhe pasardhësit e paditësit të ndjerë, kanë sjellë Certifikatën nga Enti Republikan i Gjeodezisë së Republikës së Serbisë, me të cilën vërtetohet se prona lëndore e kërkuar nga paditësit ka qenë e regjistruar në regjistrin kadastral në emër të paraardhësit të ndjerë të paditësve N P Paditësit pretendojnë se regjistrimi në emrin e tij ka zgjatë deri në vitin 1980, kur me aeroinqizim, ngastra lëndore pa ndonjë bazë ligjore ka kaluar në emër të NSH-së së paditur.

Kolegji i Apelit vëren në këtë lëndë edhe të dy palët e paditura si AKP-ja, ashtu edhe Komuna e Prishtinës, po ashtu kanë sjellë prova materiale që nuk mund të vihen në dyshim, e të cilave me saktësi të plotë u është referuar edhe Kolegji i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së në Aktgjykimin e ankimuar.

Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë i cili ka një vulë të plotfuqishmërisë, C.nr.291/2002 i datës 09.03.2010, vërteton se padia pronësore e paditësit S P pjesërisht ishte aprovuar, duke u bazuar në Kontratën e shitblerjes Vr.nr.2896/59 të datës 14.11. 1959 e cila lidhur me pronën lëndore ishte lidhur në mes të M K si shitës dhe S P si blerës.

Kjo provë fletë se megjithatë S P që nga viti 1959 e kishte blerë pronën kontestuese nga M K, ndërsa Ujdia gjyqësore, në të cilën paditësit e mbështesin padinë është më vonë, në vitin 1971. Kolegji i Apelit e ka pasur parasysh se në një procedurë tjetër sipas padisë së S P, ai e ka humbur kontestin për këto prona me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.3109/13 të datës 15.09.2016, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.4885/2016, datës 29.07.2020, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.n.31/2021, datë 21 prill 2021, mirëpo ky fakt nuk ndikon në rezultatin e dhënë me Aktgjykimi i ankimuar.

Prona kontestuese që nga viti 1985 është eksproprijuar në interes publik në emër të Komunës së Prishtinës.

Me Aktvendimin e Sekretariatit për Financa të KK Prishtina 07.nr.465-25/85 të datës 08 korrik 1985, prona kontestuese është eksproprijuar nga S P duke kaluar në emër të Komunës së Prishtinës. Vërehet se e paditura e dytë, Komuna e Prishtinës me fjalën përfundimtare me shkrim ka sjellë gjithë dokumentacionin për procedurën e zbatuar të eksproprijimit të këtyre pronave.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së në pjesën e arsytimit ligjor saktësisht i është referuar të gjitha provave dhe procedurave që janë zhvilluar lidhur me pronat lëndore. Kolegji i Apelit me këtë rast nuk sheh të nevojshme ti përsëritë të njëjtat prova dhe procedura që janë zhvilluar, pasi që ato përmenden në pjesën e rrethanave faktike të këtij Aktgjykimi.

Paditësit në padinë e tyre të precizuar dhe në fjalën përfundimtare ata pretendojnë se ishin pronar të ngastrave lëndore, dhe atë duke u bazuar në Ujdinë gjyqësore të vitit 1971, mirëpo ata të drejtën e tyre të pronësisë që është njohur me këtë Ujdi gjyqësore, nuk mundësi ta kthejnë më.

Në situatën e krijuar faktike dhe juridike pas ndërrimit të disa titullarëve pronësor sipas procedurave të zbatuara ligjore për të cilat fletë Aktgjykimi i ankimuar, dhe pas krijimit të disa ngastrave të reja, që kanë derivuar nga ngastra fillestare, nr....., këto prona edhe nëse kanë qenë të regjistruara deri në vitin 1980 në emër paditësit të ndjerë N P, siç pretendojnë paditësit, më nuk është mundur të kthehen në pronësi të tyre.

Eksproprijimi i ngastrave lëndore që ka ndodhur në vitin 1985 nuk është kundërshtuar as nga paraardhësi i ndjerë i paditësve N P e as nga pasardhësit e tij, paditësit M P1,P P dhe M P2, edhe pse si pronar që kanë pretenduar se janë, ata kanë pasë interes ligjor ta kundërshtojnë këtë eksproprijim që ka ndodhë.

Andaj nga këto arsye, mund të konstatohet se Komuna e Prishtinës ka një titull të vlefshëm pronësor në bazë të së cilës ajo i mban të regjistruara në regjistrin kadastral ngastrat lëndore të padisë.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se Komuna e Prishtinës pronat lëndore i ka eksproprijuar nga S P për të cilën është pretenduar dhe po ashtu është vërtetuar se në kohën e eksproprijimit ai ka qenë pronar i ngastrave kontestuese, e jo paditësit.

Tutje Kolegji i Apelit konstaton se edhe nëse supozohet se paditësit pa ndonjë bazë ligjore e kanë humbur pronësinë në vitin 1980, kur është bërë inqizimi aerofotogrametrike i pronës lëndore për ZK M, dhe se kjo pronë sipas pretendimeve të paditësve pa bazë ligjore ka kaluar në emër të paditurave, në bazë nenit 268 të Ligjit të Punës së Bashkuar të vitit 1976, më ata nuk kanë të drejtë ligjore ti kthejnë këto prona në pronësi të tyre. Kjo për faktin se tashmë ka kaluar afati 10 vjet i mundësisë së kthimit të këtyre pronave.

Ujdia gjyqësore në bazë të së cilës paditësit i pretendojnë pronat lëndore është lidhur në vitin 1971, pronat kontestuese pas aeroinqizimit të vitit 1980 kanë ndërruar titullarin pronësor, ndërsa padia për kthimin e këtyre pronave është dorëzuar në DHPGJS me datë 14 korrik 2008, ndërsa në Gjykatën Komunale të Prishtinës në vitin 2006, që do të thotë jashtë çdo afati ligjor të paraparë me nenin 268 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit verën se paditësit në ankesë e tyre në shkallën II-të kanë pretenduar se Kolegji i Shkallës së I-rë me Aktgjykimin e ankimuar ka shkelur nenin 182 pa. 2 pika n) të LPK-së, duke pretenduar se aktgjykimi është kundërthënës se ai nuk ka arsyetim ligjor, apo arsyet janë të paqarta.

Kolegji i Apelit e ka pasur parasysh këtë pretendim ankimor, mirëpo nuk e pranon si pretendim të bazuar, pasi që Kolegji i Shkallës së I-rë për të gjitha faktet kryesore të kësaj çështje kontestimore ka paraqitur gjerësisht gjendjen faktike duke i përmendur faktet kontestuese, dhe duke dhënë arsyetim të drejtë dhe të bazuar në prova dhe në ligj.

Kolegji i Apelit nuk i mbështet as pretendimet për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, apo pretendimet për aplikim të gabuar të dispozitave materiale, pasi janë pretendime të përgjithësuara të pafaktuara dhe të pa argumentuara dhe rrjedhimisht edhe pretendime të pa bazuara në ligj.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit nuk ka mundësi ta ndryshojë rezultatin e dhënë me Aktgjykimin e ankimuar, andaj ankesa e paditësve refuzohet si të pa bazuar, dhe e vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesit tashmë e kanë paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumë prej 100 euro me datë 21 dhjetor 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 20 qershor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
